



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:030380  
Datë: 31.10.2024  
Numri i dokumentit: 06379813

**Në çështjen juridike të :** **AC-I-23-0591-A0001**  
*Paditësi*

**A D** fshati P, Prizren

**Kundër:** *E paditura/Ankuesi*

**N.SH “Kosova Vera” – Krushë e Vogël, Rahovec** (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5550, të datës 26 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5550, i datës 26 shtator 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë me datë 25 korrik 2014, ankuesi kishte paraqitur një kërkesë për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ002-0011 të datës 18 korrik 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara për periudhën deri me 31 gusht 2009 në shumën prej 1,304.65 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme, për faktin se e njëjta në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, ishte parashkuar.

Paditësi kishte theksuar se gjithnjë vihet deri në konflikte të pakuptimta juridike sidomos në pretendimet e zbatimit të një ligji i cili në fakt ka pushuar së zbatuari shumë kohë më herët e për zbatimin e të cilit kanë qenë të informuar vetëm ata të cilit e kanë marrë një vendim për këtë. Askush nuk ka ditur për zbatimin e Ligjit për Punën e Bashkuar e tani del se i njëjti qenka i zbatueshëm dhe qenka edhe afati i parashkrimit. Gjithashtu parashtruesi kishte theksuar se ska qenë i informuar për një të drejtë të tillë dhe nuk ka mundur të dijë rrjedhën e afatit të parashkrimit, andaj konsideron se arsyetimi i AL-së është në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale, andaj i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesa dhe të anulohet vendimi i AL-së.

Me datë 1 gusht 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar që të parashtrroj prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij si dhe kopjen e vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 9 shtator 2023, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e lartcekur të gjykatës të cilit i kishte bashkëngjitur njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 26 shkurt 2010, listën e pagave për muajin shkurt 2008, analizën e pagave të papaguara nga N.SH-ja deri me datë 31 gusht 2009, kopjen e librezës së punës së paditësit,

Me datë 8 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtje në ankesën e paditësit në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të LDHP-së i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje kishte theksuar se kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit.

Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ002-0011 të datës 18 korrik 2014.

Me datë 26 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5550 kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe kishte ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ002-0011 të datës 18 korrik 2014. Ndërsa, kishte detyruar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit për paga të papaguara t'i paguaj shumën prej 1,304.65 euro. Në arsyetimin e këtij aktgjykimi ishte theksuar se ankuesi bazën e kërkesës së tij e kishte mbështetur në kopjen e njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 26 shkurt 2010, kopjen e listës së pagave për periudhën shkurt 2008, kopjen e tabelës lidhur me analizën e pagave të papaguara deri me 31 gusht 2009 dhe kopjen e librezës së punës me nr. 11798. Andaj, gjykata i kishte pranuar këto prova si relevante dhe të bazuara për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për N.SH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë N.SH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk e ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.SH në periudhën e lartcekur apo se nuk i ka mbetur pagat borxh ashtu siç përshkruhen në listën e pagave të lëshuar nga personat përgjegjës të N.SH-së. Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 1,304.6 euro gjykata është bazuar në vendimin e AL-së me të cilin kërkohet kompensimi për paga të papaguara e që është në harmoni të plotë me provat e dorëzuara nga kërkuesi.

Me datë 16 tetor 2023, e paditura kishte paraqitur ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-5550 të datës 26 shtator 2023, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të pabazuar dhe të vërtetoj të njëjtin. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëj me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, pala kundërshtare sqaron gjykatën se njoftimi që i referohet parashtruesi e informon atë se ai ka të drejtë të parashtrtoj kërkesën pranë AKP-së dhe se kërkesa të tilla do të shqyrtohen në likuidim. Duke injoruar plotësisht parashtruesin e palës

kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio.

Me datë 27 maj 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën kishte propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën deri më 31 gusht 2009 në shumën prej 1,304.65 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se afati kohor kur paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij për realizimin e së drejtës së tij të pretenduar, e njëjta ishte parashkruar dhe se i njëjti nuk kishte dorëzuar asnjë provë në mbështetje të kërkesës së tij.

Paditësi në shkallë të parë kishte bashkëngjitur provat si në vijim: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 26 shkurt 2010, listën e pagave për muajin shkurt 2008, analizën e pagave të papaguara nga N.SH-ja deri me datë 31 gusht 2009, kopjen e librezës së punës së paditësit.

Shkalla e parë e DHPGJS-së, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të pagave të papaguara

për periudhën e lartcekur në shumën prej 1,304.65 euro me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga kopja e Librezës së punës e dorëzuar si provë nga paditësi shihet që i njëjti kishte ofruar shërbime punë për N.SH deri në momentin e privatizimit të saj dhe atë me 26 shkurt 2010, kohë kur edhe i ishte mbyllur librezja e punës.

Gjithashtu, nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 26 shkurt 2010, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra në datën e lartcekur. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*. Andaj, i njëjti duke iu përmbajtur këtij njoftimi kishte paraqitur kërkesën e tij pranë AL-së brenda afatit të caktuar ligjor.

Tutje, nga tabela 6.4 e emërtuar “Analiza e Rrogave të Papaguara” deri me datë 31 gusht 2009, në të cilën tabelle paditësi ka numrin rendor 11, vërtetohet se N.SH i kishte mbetur borxh të njëjtit shumën prej 1,304.65 euro në emër të pagave të papaguara, tabelë kjo e lëshuar dhe vërtetuar nga N.SH-ja.

Prandaj, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë e DHPGJS-së me të drejtë i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensimin e pagave të papaguara për periudhën dhe në shumën e lartcekur, pasi që i njëjti mjaftueshëm e kishte dëshmuar të drejtën e tij përmes provave të lartcekura të dorëzuara në DHPGJS.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se ashtu siç me të drejtë thekson shkalla e parë, e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i ka mbetur borxh shumën që paditësi e pretendon.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 tetor 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_